



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 26, datë 13.02.2025

PËR

“VERIFIKIMIN E PASURISË DHE FIGURËS TË PROKURORES DHORINA THEODHORI, KANDIDATE PËR POZICIONIN E DREJTUESIT TË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM KORÇË”

Këshilli i Lartë i Prokurorisë me pjesëmarrjen e:

1. Zonjës Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Zotit Erind GERMENJI	Zv/ Kryetar
3. Zotit Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zotit Zeqir HODA	Anëtar (në mungesë)
5. Zonjës Arta MANDRO	Anëtar
6. Zonjës Ledina RIZA	Anëtar (në mungesë)
7. Zotit Moisi DUDA	Anëtar
8. Zotit Vatë STAKA	Anëtar
9. Zotit Olger EMINAJ	Anëtar
10. Zotit Erind MERKURI	Anëtar
11. Zotit Erion FEJZULLA	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.02.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 e vijues, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe nenet 18 e vijues të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Verifikimin e pasurisë dhe figurës të prokurores Dhorina Theodhori, candidate për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, në rikandidim”



Pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, dëgjoji relatorin Z. Moisi Duda, si edhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

1. Bazuar në parashikimin e bërë në pikën 3 të nenit 52 të Ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar si dhe në kërkesën për rikandidim të kandidates Dhorina Theodhori, Këshilli me Vendimin nr. 144, datë 18.07.2024 ka miratuar *“Fillimin e procedurave për verifikimin e pasurisë dhe figurës për kandidatin që ka kandiduar për riemërim në pozicionin e Drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë”*, si edhe ka vendosur nëpërmjet shortit, caktimin si relator Z. Moisi Duda. Sipas parashikimit të bërë në pikën 4 të këtij neni, Kryetari riemërohet për një mandat të dytë, vetëm nëse kalon me sukses verifikimin dhe nëse vlerësimi për veprimtarinë si kryetar dhe magjistrat, është të paktën *“shumë mirë”*. Verifikimi përfshin periudhën nga deklarimi i fundit i kandidates Dhorina Theodhori të bërë në kandidimin për mandatin e saj të parë në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.
2. Relatori ka zhvilluar procedurën administrative për sa më poshtë:
 - Njoftimin e kandidates për fillimin e procedurës së verifikimit si dhe për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e Relatorit, në rast të ekzistencës së një situatë konflikti interesi.
 - Njoftimin në rrugë elektronike të formularëve dhe autorizimit përkatëse, Kandidates me qëllim verifikimin nga ana e Këshillit të Lartë të Prokurorisë të të dhënave që lidhen me verifikimin e pasurisë dhe figurës së saj.
 - Konceptimin e kërkesave për informacion drejtuar institucioneve të ndryshme, në kuadër të kësaj procedure kontrolli administrativ.
 - Administrimin dhe shqyrtimin e informacioneve të administruara nga institucionet në kuadër të procedurës administrative,
 - Përgatitjen e relacionit ku pasqyrohen gjetjet dhe konkluzionet.
 - Koordinimin me Anëtarët e Komisionit për përfshirjen, diskutimin dhe miratimin e Relacionit në mbledhjet e Komisionit,
 - Njoftimet drejtuar subjektit të kësaj procedure administrative.
3. Referuar pikës 2, të nenit 32, të Ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve”* i ndryshuar, verifikimi i pasurisë dhe figurës është realizuar në bashkërendim me informacionet e ardhura nga institucionet e tjera shtetërore, kompetente për verifikimin e pasurisë dhe figurës, si ILDKPKI, Prokuroritë, organet e administratës tatimore dhe doganore, shërbimet informative, si dhe çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit. Më pas relacioni i përgatitur u diskutua dhe u miratua në Komisionin e Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale.
4. Në përputhje me procedurën përkatëse, relacioni me gjetjet paraprake iu bë me dije kandidates, e cila është shprehur se, nuk kishte qëndrim të kundërt.



5. Në përfundim të shqyrtimit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë konkludoi që procedura e verifikimit të pasurisë dhe figurës është e plotë.

PËR KËTO ARSYE:

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në nenet 159, pika 1 dhe 2 germa “a”, 184 dhe 189, pika 1, të Ligjit Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenin 32 të Ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe germën “ç”, pika 8, Seksioni Ç, Kreut VI, i Rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve”, e ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Të vlerësojë të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës të kandidatës Dhorina Theodhori, kandidate për t’u riemëruar në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.
2. Të lejojë kandidaten zonjën Dhorina Theodhori, të vijojë me procedurën e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.
3. Të njoftojë për vendimin prokuroren, zonjën Dhorina Theodhori.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 13.02.2025.

KRYETAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Erion Fejzulla

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Olger Eminaj

ZV/KRYETAR
Erind Germenji

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Erind Merkuri